

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.05.2023*

09.05.2023
Ora 13:05

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorëve për kërkesat ankimore nr.54 dhe 55.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 09.05.2023 ora 13:05, zhvillohet procedura për caktimin e relatorit, për kërkesën e ankimore numër 54, me ankues Partia Socialiste e Shqipërisë, me objekt ankimi kundërshtimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 455, me datë 06.05.2023 dhe kërkesa ankimore numër 55, me ankues objekti zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë, i cili kundërshton vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 452, datë 06.05.2023 dhe kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 446, datë 06.05.2023. Për caktimin e relatorit dhe procedur e shortit është parashikuar në nenin 14 të Rregullores së KAS-it, për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre ku në 2 janë vendosur kërkesat ankimore numër 54 dhe 55, shiritat palosen dhe vendosen në gogla, me peshë dhe ngjyrë të njëjtë, në një enë transparente. Duke qënë se anëtarët e KAS-it, nuk janë të pranishëm kanë dhënë autorizimin që të tërhiqen goglat në emër dhe për llogari të tyre nga përfaqësues i administratës të KQZ-së, vazhdojmë me rendin alfabetik rritës. Duke filluar nga zoti Ervin Lako i pari, zoti Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe Ledio Braho. Të 5 goglat që janë në enën transparente përzihen nga një përfaqësues i KQZ-së.
-Tërhiqet gogla -Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ervin Lako: - kërkesë ankimore numër 54.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.05.2023*

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Elvis Çefa: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ilirjan Rusmali: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Koli Bele: - kërkesa ankimore numër 55.

Në fund, në emër dhe për llogari të:

Z. Ledio Braho: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit, relator i kërkesës ankimore numër 54, u caktua zoti Ervin Lako dhe relator i kërkesës ankimore numër 55, u caktua zoti Koli Bele, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

